



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.10.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 16:10 dhe mbaroi në orën 16:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

*Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 01.10.2020*

3. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.

4. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Kryetarja e Këshillit znj. Llagami çel mbledhjen e ditës së sotshme mbi “Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska parashtroi se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka sjellë për shqyrtim disa relacione që kanë të bëjnë me nevojat e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për çështje që kanë karakter tepër urgjent ose urgjent. Zoti Toska thekson se në këtë mbledhje janë futur vetëm një pjesë të këtyre kërkesave, pasi siç edhe ka njoftuar në e-mail, po përgatiten akte për përfshirjen në skemë delegimi për disa gjyqtarë duke bërë të mundur që në një të ardhme të afërt shumë nga nevojat e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm të zgjidhen nëpërmjet skemës së delegimit. Gjithashtu zoti Toska informon edhe mbi përgatitjen e një projektvendimi sa i përket zbatimit të vendimit nr. 30/2019 në lidhje me gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Në këtë mbledhje do të shqyrtohen 4 relacione që janë: Gjykata e Apelit Gjirokastër, Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Vlorë.

Vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”.

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastër** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore, 2 në lëndë civile dhe 3 në lëndë penale, me karakter “tepër urgjent” ose “urgjent”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 5 çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë në varësi të rezultateve të shortit.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin çështjes civile nr.2 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështje, konkretisht: z.Sokol Ngresi dhe z.Nazmi Troka.

Në shortimin çështjes penale nr.3 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështje, konkretisht: znj.Margarita Buhali, Z.Skënder Damini.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Margarita Buhali.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Skënder Damini.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Nazmi Troka.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Klodiana Gjyzari.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 16 çështje gjyqësore, çështje të karakterit tepër urgjent ose urgjent.

Kërkesat nga nr. 1 deri në nr. 7 duhet të konsiderohen të ezauruara nga ana e Këshillit, në kushtet kur kërkesat janë bërë përpara se Këshilli të kishte marrë vendimin nr. 317, datë 16.09.2020 “Për Komandimin e gjyqtarës znj. {...} në skemën e delegimit të

ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një afat 1-vjeçar”, si dhe Vendimin nr. 318, datë 16.09.2020, me të cilin “Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.{...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 16.09.2021”.

Për rrjedhojë, në zbatim të neneve 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 97/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i propozon Këshillit që të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të 7 kërkesave të Gjykatës së Apelit Korçë.

Propozimet vijuese të Komisionit me tej sa i përket kërkesave të tjera ato të nr. 8 deri në nr. 16, janë: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Propozimet vijuese janë:

Për 9 çështje, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë që janë caktuar më herët, në vijimësi, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, konkretisht midis gjyqtarëve Valdete Hoxha, Genti Shala dhe Shkëlqim Mustafa.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 10, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 16, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 11, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 12, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 15, penale, gjyqtari Genti Shala.

Për çështjen nr. 14, penale, gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 13, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtarët Genti Shala dhe Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarët Valdete Hoxha dhe Genti Shala.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 8 çështje gjyqësore, 3 në lëndë civile dhe 5 në lëndë penale, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Për kërkesën nr. 4 të Gjykatës së Apelit Shkodër, kjo e fundit me e-mailin e datës 30.09.2020, e ka tërhequr atë, shkak për të cilin Këshilli bazuar në nenin 90/3 dhe 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe në nenin 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar për shqyrtimin e kësaj kërke dhe ky është edhe propozimi i Komisionit.

Ndërkohë që sa i përket çështjeve të tjera, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës. Në çdo rast, gjyqtari i caktuar si relator për çështjen nr. 7, nuk duhet të jetë relator edhe për çështjen nr. 8.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtari Desart Avdulaj (relator), Anita Mici dhe Valbon Çekrezi (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarët Izet Dushaj dhe Anita Mici.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarët Valbon Çekrezi dhe Desart Avdulaj.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarët Izet Dushaj (relator), Anita Mici dhe Valbon Çekrezi (anëtarë).

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarët Desart Avdulaj dhe Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtarët Anita Mici (relatore), Valbon Çekrezi dhe Desart Avdulaj (anëtarë).

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Izet Dushaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore në lëndë penale, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë në varësi të rezultateve të shortit.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: znj. Miranda Andoni. Gjithashtu kjo gjyqtare për çështjen nr. 2 ka pengesë ligjore për gjykimin e saj si dhe për çështjen nr. 3 është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështje.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Dritan Banushi.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Irena Brahimë dhe Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Izet Salaj.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Dritan Banushi.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Irena Brahimë dhe Enton Dhimitri.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor